



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2020:097223

Datë: 13.07.2021

Numri i dokumentit: 01990356

P.nr. 1/21

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore Prizren – dega në Suharekë, gjyqtari Robert Tunaj, me sek. Juridike F. Kabashi, në lëndën penale kundër të akuzuarit B. S. G. nga Suhareka, për shkak të veprave penale ndërtimi pa leje nga neni 359 par. 2 dhe heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose ishenjave nga neni 406 të KP, duke vendosur sipas aktakuzes të PTH në Prizren PP.II.nr. 1265-15/20 të dt. 30.12.2020, në seancën gjyqësore të mbajtur me dt.08.07.2021 në prezencë të PSH Atnor Skoro, të akuzuarit dhe mbrojtësi av. N. M., mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 13.07.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B. G., nga i ati S., e ëma A., e lindur J., i lindur me dt. nga Suhareka, i martuar, ka te kryer arsimin e mesëm, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

I.Se nga dt. 20.05.2020 deri më dt. 29.05.2020 në Suharekë, saktësisht në zonën industriale në Sh. në rrugën “U. B.” ka filluar të ndërtojë objektin afarist me etazhitet P+1, pa leje ndërtimore dhe duke mos respektuar urdhërate e inspektoreve të ndërtimit, në atë mënyrë që edhe përkundër faktit që është urdhëruar nga inspektori që ti nderpese punimet deri sa të pajiset me leje ndërtimore nga drejtoria kompetente D.H.U.P por që i njëjti nuk i ka ndërprerë punimet dhe ka vazhduar me ndërtimet pa leje nga organi kompetent.

Me këto veprime ka kryer veprën penale ndërtimi pa leje nga neni 359 par. 2 te KP.

II Me datë 22.05.2020 në Suharekë, saktësisht në zonën industriale në Sh. në Rrugën “U. B.” heq ose dëmton vulën zyrtare apo shenjen e ngjitur nga zyrtari i autorizuar me qëllim të sigurimit të objektit ose te lokaleve, në atë mënyrë që nuk ka respektuar urdhërin e inspektoriatit për ndalimin e punimeve, ashtu që i pandehuri këput shiritat e vendosur nga inspektorati komunal dhe vazhdon me punimet të cilat i janë ndërprerë pas inspektimit të bere nga inspektorët në vendin e ngjarjes.

Me këto veprime ka kryer veprën penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 te KP

Andaj gjykata ne kuptim të nenit 38,39,40,42,43,69,70,359 par. 2 dhe 406 te KP dhe nenit 365,450 dhe 463 të KPP, të akuzuarin e:

G J Y K O N

Për veprën penale si në dispozitivin nën I me dënim me gjobë në shumë prej 700 € dhe dënim me burg prej 6 muajsh. Me pëlqimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit dënimi me burgim prej 6 muajsh , i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 2500 €.

Për veprën penale si në dispozitivin nën II, i shqipton denim me gjobë në shumë prej 500 €.

Me aplikimin e dispozitave të nenit 80 të KP, mbi shqiptimin e denimit për bashkim të veprave penale, gjykata të akuzuarit i shqipton:

DENIM UNIK ME GJOBË

Duke i caktuar gjobën në shumë prej 3700 €, të cilin dënim i akuzuari duhet të paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, po qëse denimi me gjobë nuk mund të realizohet as detyrimisht, i njëjti do të zavendësohet me denim burgimi, duke llogaritur për 20 €, të filluar me një ditë burg, konform nenit 43 paragrafi 3 të KP.

Obligohet i akuzuari me shpenzimet e procedurës në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20 € dhe taksen për kompenzim të viktimave të krimit shumën prej 30 €.

E dëmtuara Komuna e Suharekës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

PTH në Prizren me aktakuzën PP.II.nr. 1265-15/20 të dt. 30.12.2020, ka akuzuar B. S. G. nga Suhareka, për shkak të veprave penale ndërtimi pa leje nga neni 359 par. 2 dhe heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 të KP, aktakuzën të cilën gjate shqyrtimit gjyqësor e ka përfaqësuar PSH Atnor Skoro.

Në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datën 08.07.2021, është lexuar aktakuza nga Prokurori i Shtetit dhe pas leximit të aktakuzës i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprat penale me të cilën akuzohet duke deklaruar se pranoj fajsinë për veprat penale që akuzohem dhe ka kërkuar nga gjykata të i shqiptohet një dënim më i butë.

Mbrojtësi av. N. M. në seancë ka deklaruar se i mbrojturi im ka pranuar veprën penale në seancën e sotshme, ka pranuar gabimin respektivisht veprën penale te kryer dhe i njëjti është penduar dhe pendohet, premton qe në të ardhmen nuk do te përsërit ndonjë vepër të tillë të njejtë apo te ngjajëshme , duke i marrë para sysh rrethanat të gjithë jemi të vetëdijshëm ka qenë një kohë në atë periudhë qytetari nuk ka qene ne gjendje të nxjerr një ekstrakt të lindjes e mos te flasim ndonjë dokumentacion tjetër për te cilin nevoitet një procedure shumë e gjate edhe pse i mbrojturi im ka qenë ne procedurë të nxjerrjes se ati dokumenti te lejes mirëpo si thash në rrethanat e cekura nuk ka qene e mundur me kohe te sigurohet. Është njeri familjar në të kaluarën nuk është ndesh me ligjin, rrjedhe nga një familje e cila ka veprimtari biznesor, ku punëson një numër shumë te madh të punëtorve dhe siguron kafshatën e bukës për anëtarët e familjes se tyre. Nuk i ikim gabimit te bërë, mirëpo e lusim gjyqtarin e këtij rasti duke pas para sysh te gjitha këto sipër cekura me rastin e marrjes se vendimit lidhur me rastin ne fjale për te cilin jemi sot qe krahas rrethanave qe rëndojn ti kenë parasysh edhe rrethanat lehtësuese

te përcaktuara sipas nenit 69 dhe 70 të KP. Dhe te mbrojturit tim ti shqiptoi një dënim sa me te bute eventualisht një dënim me gjobë me te cilin do te arrij efektin e denimit ne ketë ketë qeshje penale.

Prokurori i Shtetit lidhur me deklarimin e të akuzuarit për pranimin e fajsisë, ka theksuar se nuk e kundërshton deklarimin e të akuzuarit për ta pranuar fajsinë për faktin se gjykaat paraprakisht është siguruar që i njejtë të kuptoj natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë, dhe pranimi i fajsisë bëhet me vullnet dhe i pa ndikuar dhe ky pranim është bërë konform dispozitave të nenit 248 të KPRK-së dhe si të tillë nuk e kundërshtoj.

Gjyqtari vetëm gjykues pas deklarimit të të akuzuarit, mbrojtësit dhe prokurorit të shtetit rreth pranimit të fajsisë ka marrë aktvendim me anë të cilit ka aprovuar deklarimin e të akuzuarit për pranimin e fajsisë duke vlerësuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë konform nenit 248 të Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 04/L-0123 . Pastaj gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë, se pranimi bëhet vullnetarisht nga i akuzuari, në prani të mbrojtjes ,se pranimi i fajit mbështete në faktet e qështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke u bazuar në deklarimin e të akuzuarit për ta pranuar fajsinë në tërësi për të gjitha pikat e aktakuzës, gjykata nuk administroi me provat në këtë çështje penale juridike, pasi që gjykata ka konstatuar dhe vërtetuar të tërësi këtë gjendje të pakontestueshme faktike.

Në tersi është vërtetur se me dt. 20.05.2020 deri më dt. 29.05.2020 në Suharekë, saktësisht në zonën industriale në Sh. në rrugën “U. B.” ka filluar të ndërtojë objektin afarist me etazhitet P+1, pa leje ndërtimore dhe duke mos respektuar urdhërate e inspektoreve të ndërtimit, në atë mënyre që edhe përkundër faktit që është urdhëruar nga inspektori që ti nderpese punimet deri sa të pajiset me leje ndërtimore nga drejtoria kompetente D.H.U.P por që i njëjti nuk i ka ndërprerë punimet dhe ka vazhduar me ndërtimet pa leje nga organi kompetent.

Me datë 22.05.2020 në Suharekë , saktësisht në zonën industriale në Sh. në Rrugën “U. B.” heq ose dëmton vulën zyrtare apo shenjen e ngjitur nga zyrtari i autorizuar me qëllim të sigurimit të objektit ose te lokaleve, në atë mënyrë që nuk ka respektuar urdhërin e inspektorijatit për ndalimin e punimeve, ashtu që i pandehuri këput shiritat e vendosur nga inspektorati komunal dhe vazhdon me punimet të cilat i janë ndërprerë pas inspektimit të bere nga inspektorët në vendin e ngjarjes.

Gjykata sipas detyrës zyrtare në shkresat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë provë të pa pranueshme dhe po ashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë, pranimi i fajit nga ana e të akuzuarit është bërë vullnetarisht në shqyrtimin gjyqësor, pranimi është mbështetur në faktet e qështjës që përmban aktakuza, siq janë deklarata e H. M. të dhënë me dt. 31.08.2020, deklarata e J. Rr. të dhënë me dt. 01.09.2020, regjistrin e urbanizimit lidhur me lejet ndërtimore dhe foto dokumentacioni, si prova materiale të paraqitura ndaj të akuzuarit nga ana e PTH në Prizren.

Gjykata po ashtu në tersi ka ardhur në përfundim se pranimi i fajsisë në shqyrtimin gjyqësor nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 248, nga se nuk egziston ndonjë nga arsyerat dhe kushtet për hudhjen e propozimit akuzues, apo pushimin e procedurës penale si dhe nenit 253 të KPP. Dhe nga këto fakte të cilat i përmban aktakuza, gjykata ka ardhur në përfundim se me veprimin e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qënjes së veprave penale nga neni 359 par. 2 dhe 406 KP, gjykata ka vendosur të akuzuarin ta shpallë fajtor, dhe ta shqiptoi dënimin si ne dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata gjatë marrjes së vendimit mbi denimin ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KP-së.

Gjykata si rrethanë lehtësuese pati parasysh se i akuzuari ka patur qëndrimin korrekt ndaj gjykatës, pranimin në tersi të veprave të kryera, është penduar për veprat e kryera, i ka premtuar gjykatës se do ti ndërpres veprimet e kundërligjshme në të ardhmen, më parë nuk ka qenë i dënuar kurse rrethane rënduese shkallen e lartë të dashjes.

Për veprë penale si në dispozitivin I, është paraparë dënimi me gjobë dhe me burg prej 6 muajve deri në pesë vite, gjykata i'a ka shqiptuar dënimin me gjobë dhe burgim sikurse në dispozitiv I. të aktgjykimit e me pëlqimin e të akuzuarit dënimin me burgim e ka zavendësuar në përputhje me nenin 44 të KP-së, ndërsa për veprën penale si në dispozitivin II, është paraparë dënimi me gjobë ose burgim deri 3 vjetë, ndërsa të të njëjtit i'u shqiptua dënimi me gjobë sikurse në dispozitivin II. të aktgjykimit me bindjen se këto dënime janë në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjesisë penale të akuzuarit dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë që të parandaloi të akuzuarin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe të bëjë rehabilitimin e tij si dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Vendimin që të i dëmtuarën lidhur me kërkesën pasurore juridike për kompenzimin e dëmit të shkaktuar me këtë veprë penale të udhëzoj në kontest civil, gjykata e bazoi në nenin 463 parag. 2 të KPP-së, pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm të kësaj kërkesë.

Vendimin mbi paushallin gjyqësor gjykata e bazoi ne nenin 450 parag. 3 të KPPK-së ashtu që lartësia e paushallit gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzetë euro), Euro u caktua duke pasur parasysh zgjatjen dhe ndërlikueshmërinë e procedurës penale si dhe gjendjen financiare të të akuzuarës .

Vendimi me të cilin është i obliguar i akuzuari që të bëjë kompenzimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par. 3 nën par. 3.2 te Ligjit per kompenzimin e viktimave të krimit.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2020:097223, 13.07.2021

G j y q t a r i

Robert Tunaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.